



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI BASHKIAK

PROTOKOLLI 8

REND-DITE

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. **Projekt-Vendim** “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore në vendimin nr 152 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Kolonjë per vitin 2026.”
3. **Projekt-Vendim** “Për shtesë fondi dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore Në vendimin nr.152, datë 22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e keshillit bashkiak nr.32 datë 20.02.2026.”
4. Për miratimin e buxhetit shtesë të bashkisë Kolonjë per vitin 2026.”
5. **Projekt-Vendim** “Për dhenien e titullit qytetar nderi i Bashkisë Kolonjë Z.Ludhi Miçi.”
6. **Projekt-Vendim** “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore në vendimin nr 152 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Kolonjë per vitin 2026.”
7. **Projekt-Vendim** “Për shtesë fondi dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore Në vendimin nr.152, datë 22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e keshillit bashkiak nr.32 datë 20.02.2026 “Për miratimin e buxhetit shtesë të bashkisë Kolonjë per vitin 2026.”

Protokolli i mbajtur sot më date 15.06.2026 në mbledhjen e jashtë rradhe sipas njoftimit të dhënë në datën 11.06.2026.

Të pranishëm: E. Xhelili, B.Jashari, I.Milo G.Tafili, E.Avdi, P.Çunge, Z.Meto, A.Zeneli, S.Kodra, E.Çikopana.

Mungon: H.Iljazi, S.Larti, T.Çaçani, I.Hodo, A.Tartari.

E. Xhelili: Përshëndetje, fillojmë me mbledhjen jashtë rradhe të datës 15.06.2026, pika e parë e rendit të ditës. Jeni dakort me rendin e ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Ka dikush prej jush konflikt interesi me ndonjë nga pikat e rendit të ditës?

E. Xhelili: Nuk ka asnjë konflikt interesi.

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës “ Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore në vendimin nr 152 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Kolonjë per vitin 2026.”

I.Milo: Fondi ka ardhur nga Këshilli i Qarkut?

G.Duka (Drjetoresh Finance) : Në mbështetje të fondit të transferuar nga Këshilli i Qarkut Korçë, paraqitet propozimi për shtesë dhe shpërndarje të fondeve në buxhetin e Bashkisë Kolonjë për vitin 2026. Këshilli i Qarkut Korçë ka akorduar një fond në vlerën 660,000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për financimin e aktivitetit kulturor “Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Sazeve Popullore”, i cili do të realizohet nëpërmjet Qendrës Kulturore “Fan S. Noli” Ersekë.Për rrjedhojë, propozohet miratimi i shtesës së buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 në shumën 660,000 lekë dhe shpërndarja e këtij fondi sipas klasifikimit buxhetor përkatës, me qëllim sigurimin e mbështetjes financiare për zhvillimin e aktivitetit në fjalë.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën dy të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën tre të rendit të ditës Për shtesë fondi dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore Në vendimin nr.152, datë 22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e keshillit bashkiak nr.32 datë 20.02.2026.”

G.Duka (Drjetoresh Finance) : Nëpërmjet kësaj kërkesë, ju paraqesim rastin e z. Anasatas Rrushi, punonjës pranë Bashkisë Kolonjë prej rreth 40 vitesh në Drejtoarin e Artit, Kulturës dhe Sportit.Z. Rushi ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale në sy dhe për shkak të kostove të larta të trajtimit, ndodhet në pamundësi financiare për të përballuar shpenzimet e operacionit. Për këtë arsye, kërkon mbështetjen financiare për përballimin e këtyre shpenzimeve, duke marrë në konsideratë kontributin dhe përkushtimin e tij shumëvjeçar në shërbim të Bashkisë Kolonjë.

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën tre të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën kater të rendit të ditës “Për dhenien e titullit qytetar nderi i Bashkisë Kolonjë Z.Ludhi Miçi.”

A.Zeneli: Propozimi është paraqitur nga Komiteti i Veteranëve dhe, duke vlerësuar kontributin e çmuar dhe veprimtarinë e tij të shquar profesionale e shoqërore, jemi dakort që z. Ludhi Mici të nderohet me titullin ‘Qytetar Nderi’ i qytetit të Leskovikut.”

E. Xhelili: Jeni dakort me pikën katër të rendit të ditës?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili: Janë paraqitur edhe dy projekt-vendime shtesë, jeni dakort të përfshihen në rendin e ditës ?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili: Me dakordësinë e të gjithë anëtarëve, vendosën që projekt-vendimet të përfshihen në rendin e d

E. Xhelili: Vazhdojmë me projekt vendimin “Për rishpërndarjen e fondeve buxhetore në vendimin nr 152 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Kolonjë per vitin 2026.”

G.Duka (Drjetoresh Finance) : Në kuadër të ushtrimit të funksioneve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, mjetet e punës në administrim (fadroma Caterpillar, fadroma JCB dhe kamioni me kosh) kanë pësuar defekte të përsëritura gjatë punës në terren, duke dalë pjesërisht ose plotësisht nga funksioni.JJane kryer sherbime dhe nderhyrje te mëpareshme te financuara nga fondet e lena te sherbime dhe pjese kembimi nga buxheti i viti 2026, problematikat kane rikithim te perseritur , duke sjelle nevojën për nderhyrje te re sipas gjendjes se poshteshenuar. Mjetet jane te amortizura dhe terenet ku punojme jane shume te veshtira dhe krijojne defkte.Sherbimet qe do te kryhen ne Fadrmon Caterpillar janë nderim ure e parë,diferencjal,mocot e para. riparim i linjës së frenave , riparim i pistonave ,nderim i tubove të hidraulikut,nderim i kokave te paralelit mbrapa,r iparimi i pompës se naftës.Sherbimet qe do kryhen në Fadromen JCB është riparimi i linjës së frenave .Riparim i kamjonit me kosh janë vendosja e pompës së hidraulikut dhe tubo te linjës dhe aksesore të tjerë .

E. Xhelili: Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Vazhdojmë me projekt vendimin “Për shtesë fondi dhe shpërndarjen e fondeve buxhetore Në vendimin nr.152, datë 22.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026 dhe vendimin e keshillit bashkiak nr.32 datë 20.02.2026 “Për miratimin e buxhetit shtesë të bashkisë Kolonjë per vitin 2026.”

G.Duka (Drjetoresh Finance): Kemi dhe një rishpërndarje në fondeve buxhetore të Bashkisë Kolonjë për vitin 2026. Një fond prej 2,000,000 lekësh do të zhvendoset nga investimi “Rikonstruktion Urban Lagjia nr. 1” dhe do të përdoret për ndërtimin e një muri mbajtës me gabione në aksin rrugor Qafzez–Çlirim, në Njësinë Administrative Mollas-Çlirim.

Nevoja për këtë ndërhyrje ka ardhur si pasojë e dëmtimeve të shkaktuara nga reshjet e shumta të shiut, të cilat kanë sjellë rrëshqitje dherash, bllokim të rrugës, dëmtim të murit mbajtës dhe rrezik për sigurinë e banorëve dhe qarkullimin. Sipas vlerësimit të riskut: Rrezikohet siguria publike, rrezikohen jetët e banorëve, pengohen aktivitetet private dhe ekonomike, ekziston rrezik për degradim mjedisor dhe përkeqësim të situatës nga fatkeqësitë natyrore.

E. Xhelili: Jeni dakort me projekt-vendimin?

Pro 10 Kundër 0 Miratohet

Proces-Verbali i datë 15.06.2026 është firmosur nga 10 anëtarë Këshilli.

SEKRETAR I KËSHILLIT
INSUIDA ORHANAS



KRYETAR I KËSHILLIT
ERALDO XHELILI

